

L I G J
Nr.8277, datë 15.1.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7697, DATË 7.4.1993 “PËR KUNDËRVAJTJET
ADMINISTRATIVE”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 21 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Zbatimi i dënimeve me gjoba fikse të vendosura nga organet e shërbimit të policisë rrugore bëhet me pagimin e vlerës së tyre nga kundërvajtësi në arkën e njërit prej komisariateve të policisë, në territorin e të cilit është kryer kundërvajtja administrative ose ku e ka vendbanimin kundërvajtësi.”

Neni 2

Dekreti nr.1231, datë 26.9.1995 “Për një ndryshim në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, miratuar me ligjin nr.8016, datë 25.10.1995, shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1992, datë 21.1.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani